



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:015128

Datë: 29.06.2020

Numri i dokumentit: 00994039

**P.nr.100/20**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**, me gjyqtaren Fitore Daci si dhe bashkëpunëtorin profesional Shkelzen Polloviqi, në çështjen penale kundër të pandehurit Ç.N për shkak të veprës penale Vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës PP/II.nr.97-1/20 të datës 31.01.2020 të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar dhe publik të mbajtur me datë 17.06.2020 në praninë e Prokurores së Shtetit Albana Parduzi dhe të pandehurit Ç.N, me datë 17.06.2020, mori dhe publikisht shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **I pandehuri:**

Ç.N i lindur me datë ..., në fshatin ..., Komuna Shtime, nga i ati A..., ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, kujdestar i familjes prej gjashte anëtarësh, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ...

### **ËSHTË FAJTOR**

#### **Sepse:**

Me datë 19.11.2019, rreth orës 14:30, në pyllin publik të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Komuna e Ferizajt, në rajonin ekonomik-pyjor Nerodime-Jezerc, në vendin e vendin e quajtur “N...”, i pandehuri me qëllim të vjedhjes me sharrë motorike ka

prerë 2 trungje të llojit Ahu, me diametër 37-60 cm, boniteti III, me vëllim të përgjithshëm 3,36 metër kub, në atë rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 453,60 €.

**me të cilin veprim ka kryer veprën penale Vjedhje Pylli nga neni 349 par.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e:

## **G J Y K O N**

**Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4/ katër / muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej një viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk do të kryej vepër të re penale.

Obligohet i pandehuri që të dëmtuarës Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj, të ia paguajë dëmin në shumën prej 453,60 €/ katërqind e pesëdhjetë e tre euro e gjashtë dhjetë cent/.

Konform nenit 453 par.4 të KPPRK-se, i pandehuri lirohet nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale, sepse pagesa e shpenzimeve do të rrezikon gjendjen e tij të rënduar materiale.

## **Arsyetimi**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me Aktakuzën PP/II.nr.97-1/20 të datës 31.01.2020 ka akuzuar të pandehurin Ç.N për veprën penale Vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 17.06.2020 në të cilin shqyrtim ishin të pranishëm prokurorja e shtetit Albana Parduza dhe i pandehuri L.G.

Pasi që gjykata e ka udhëzuar të pandehurin në kuptim të nenit 246 par.1 të KPPK-se dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, në pajtim me nenin 246 par.3 të KPPK-së shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, duke vepruar sipas nenit 246 par.4 të KPPK-së i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I pandehuri Ç.N lidhur me të drejtën për tu deklaruar për fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që e ngarkon aktakuza, duke shtuar se i vjen keq për këtë vepër penale, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale si dhe e ka lutur gjykatën që të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe t'i shqiptojë një dënim më të butë ngase ka kushte tejet të rënda ekonomike.

Prokurorja e shtetit Albana Parduçi duke shprehur mendimin e saj lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtit, meqë ky pranim është i bazuar në gjendjen faktike të përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze, pranimin e fajësisë i pandehuri e ka bërë vullnetarisht dhe se një pranim i tillë është në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 248 të KPPK-së si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Meqë i pandehuri ka pranuar fajësinë, gjyqtarja e vetme gjykuese ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par. 1 të KPPK-së, i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: Procesverbali i përpiluar nga komisioni i ekspertëve të pylltarisë për vlerësimin dhe konstatimin e dëmit të shkaktuar nga i pandehuri Np.476/19 i datës 02.12.2019 , Fletëparaqitja e rojës së pyllit me numër 476/19 i datës 02.12.2019, fotografitë si dhe shkresat e tjera që gjenden në dosjen e lëndës dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtarja e vetme gjykuese konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhje Pylli nga neni 349 par.1 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të përshkruar në datën, vendin, kohën dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 71 dhe 72 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se në shqyrtimin fillestar i pandehuri e ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, nuk ka dëshmi se është gjykuar me vendim të formës së prerë, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, gjendjen tejet të dobët ekonomike, mbajtës i familjes, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës speciale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Vendimi mbi detyrimin e pagesës së dëmit është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 të KPPRK-së.

Konform nenit 453 par.4 të KPPRK-se, i pandehuri lirohet nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale, sepse pagesa e shpenzimeve do të rrezikon gjendjen e tij të rënduar materiale.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr.100/20, me datë 26.06.2020**

**Bashkëpunëtori profesional**

**Gjyqtarja**

**Shkelzen Polloviqi**

**Fitore Daci**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.